

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____

PËR

KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRFITIMIT,
TË POSEDUESVE TË NDËRTIMEVE PA LEJE NË RASTET E
FATKEQËSISË NATYRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 30, të ligjit nr.20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME

1. Ky vendim rregullon kushtet, kriteret dhe procedurat e përfitimit, të individëve dhe familjeve, të cilët posedojnë ndërtime pa leje me funksion banimi, që pësojnë dëme, për shkak të fatkeqësive natyrore.
2. Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
 - a) “**Ligji**” është ligji nr.20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;
 - b) “**Përfitues**” është subjekti posedues i një ndërtimi pa leje me funksion banimi, që rezulton i dëmtuar pas një fatkeqësie natyrore, në një njësi të vetëqeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore;
 - c) “**Ndërtim pa leje**” është ndërtimi i lidhur në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose me ndërtesa të tjera, i cili është bërë pas datës 10.8.1991 me funksion banimi, i cili paraqitet si objekt, si shtesë në ndërtim të regjistruar/në mungesë të lejes së ndërtimit, ose si objekt në shkelje të lejes së ndërtimit;
 - ç) “**Organ përgjegjës/njësi zbatuese**” është njësia e vetëqeverisjes vendore ose organi publik i ngarkuar nga Këshilli i Ministrave, të

administrojë fondet e transferuara për rindërtimin ose që mbulon çështjet e strehimit.

II. KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E TRAJTIMIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE NË RASTET E FATKEQËSISË NATYRORE

1. Për të përfituar nga trajtimi në rastet e fatkeqësisë natyrore duhet të plotësohen kushtet dhe kriteret e mëposhtme:
 - a) Ndërtimi pa leje të rezultojë i dëmtuar pas një fatkeqësie natyrore, në një njësi të vetëqeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore;
 - b) Ndërtimi pa leje të jetë përfshirë në procedurat e legalizimit dhe për të, të mos ketë përfunduar procesi administrativ me vendimmarrje për legalizim;
 - c) Ndërtimi pa leje të rezultojë me funksion banimi, gjatë evidentimit në terren që kryen ASHK, sipas ligjit;
 - ç) Individit ose familja të mos ketë ndërtim tjetër në pronësi apo më shumë se një ndërtim pa leje me funksion banimi në proces legalizimi, në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore. Kur individit apo familja ka disa ndërtime në pronësi apo në proces legalizimi dhe të gjitha ato dëmtohen si pasojë e fatkeqësisë natyrore, atëherë përfiton, vetëm për banesën që në datën e fatkeqësisë natyrore përdorej si vendbanim i zakonshëm.
2. Procedura e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që dëmtohen nga fatkeqësia natyrore nis me kërkesën e organit përgjegjës/njësisë zbatuese drejtuar ASHK-së.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga paraqitja e kërkesës nga organi përgjegjës/njësia zbatuese, drejtoria vendore e ASHK-së evidenton në terren ndërtimet pa leje dhe verifikon nëse për to është paraqitur kërkesë për legalizim. Kur rezulton se është paraqitur kërkesë, brenda të njëjtit afat kryhet dhe procedura e përjashtimit nga legalizimi.
4. Vendimmarrja e përjashtimit sipas pikës 3 të këtij kreu, i përcillet organit përgjegjës/njësisë zbatuese dhe shoqërohet nga:
 - a) Dokumentacioni hartografik (genplan dhe planimetri);
 - b) Ekstrakti nga baza e të dhënave;
 - c) Informacion kadastral;
 - ç) Të dhëna nëse përfituesi zotëron apo jo banesë tjetër të ligjshme brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Kjo vendimmarrje i njoftohet njëkohësisht dhe subjektit posedues të ndërtimit pa leje, sipas mënyrës dhe afateve të parashikuara në ligj dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

5. Mënyra e trajtimit dhe kriteret për përfitimin e sipërfaqeve ndërtimore të subjekteve përfitues sipas këtij vendimi, është sipas parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave për kushtet dhe kriteret e përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje, miratuar në zbatim të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.
6. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore, organet publike që preken nga ky vendim dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

ED I R A M A